



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**SHËRBIMI INFORMATIV I SHTETIT**

**NJOFTIM PER SHTYP**

Përfaqësues të Shërbimit Informativ të Shtetit morën pjesë në takim informues me diplomatët e rinj të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Ndër të tjera, diplomatët u njohën edhe me mesazhin e zëvendësdirjtorit të SHISH-it, z. Helidon Bendo.

**MESAZH**  
**PËR**  
**DIPLOMATËT E RINJ**

**Të nderuar diplomatë,**

Fillimisht më lejoni t'ju uroj punë të mbarë në detyrën Tuaj.

Shërbimi Informativ i Shtetit vlerëson maksimalisht bashkëpunimin e frytshëm me Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme, si dy partnerë të rëndësishëm në mbrojtjen e interesave kombëtare të Republikës së Shqipërisë. Unë konstatoj me kënaqësi dhe vlerësim se sot Shërbimi Informativ i Shtetit dhe Shërbimi i Jashtëm janë bashkëudhëtarë me kontribute të pamohueshëm në forcimin e sigurisë kombëtare dhe marrëdhënieve ndërkombëtare të Republikës së Shqipërisë. Në emër të SHISH-it, unë uroj që bashkëpunimi ynë i deritanishëm të marrë vlerë të shtuar edhe me kontributin Tuaj.

*Të nderuar diplomatë,*

Siç mund të jeni në dijeni, vit pas viti Shqipëria e ka rritur besueshmërinë e saj pranë partnerëve strategjikë, si një aktor i konfirmuar përkundrejt sigurisë së NATO-s dhe Bashkimit Evropian. Në këtë kuptim, orientimi i Shqipërisë është shumë i qartë, përkrah aleatëve strategjikë, me të cilët ndajmë vlera të përbashkëta.

Megjithatë, sfidat tona mbeten të mëdha, ndërsa koncepti i sigurisë kombëtare tashmë ndryshon e shtrihet edhe përtej përcaktimit klasik. Në këtë drejtim, bashkëpunimi mes Shërbimit Informativ të Shtetit dhe Shërbimit të Jashtëm merr një rëndësi të veçantë.

Në mbyllje, në emër të Shërbimit Informativ të Shtetit, unë Ju garantoj se në rrugën Tuaj të gjatë dhe aspak të lehtë të diplomatit, do të keni bashkëpunimin dhe ndihmën e pakursyer të komunitetit të inteligjencës.

**Zëvendësdrejtori/Drejtori në detyrë  
Helidon Bendo**

**KABINETI**  
Tiranë, më 14.06.2018